



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 437/23 prot.

Datë 24.03.2026

**V E N D I M**

**Nr. 416/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.353/2026, datë 05.03.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-68208-11-10-2025, me objekt: “Furnizimi me ujë për fshatrat Picar & Kolonjë të Bashkisë Gjirokastër”, me fond limit 129,188,262.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 11.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Gjirokastër Sh.a.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Liçeni VII” Shpk, me NIPT K01730502Ë dhe adresë: Rruga "Dituria", Zona Kadastrale nr.8516, Nr.pasurie 10/268, Lagjja 14, Kodi Postar 2007, Shkozë, Durrës.

BOE “LIS Konstruksion” Shpk (përfaqësues) me NIPT K66613407H, dhe me adresë: Bulqizë, Lagjja Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15 &” Viantë Konstruksion” SHPK me NIPT K47103804L.

**Subjekt i interesuar:** BOE “O.B.Konstruksion” SHPK (përfaqësues) me NIPT K93728201A dhe adresë: KRUIJE, Qendër Krujë, Lagjja Nr.1. & “ED Konstruksion” Shpk.

**Autoriteti Kontraktor:**

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a.  
me adresë: Rr.Muharrem Gega "Nd.24, Hyrj. 1,  
Gjirokastër.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar,  
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021  
"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i  
ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.  
766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për  
organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit  
Publik", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit  
Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për  
Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e  
Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit  
Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga  
COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

**Vëren:****I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 05.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.353/2026, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e OE ankimues "Liqeni VII" SHPK për procedurën e prokurimit "E hapur", me REF-68208-11-10-2025, me objekt: "Furnizimi me ujë për fshatrat Picar & Kolonjë të Bashkisë Gjirokastër ", me fond limit 129,188,262.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 11.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE ankimues "Lis Konstruksion Shpk & "Viante Konstruksion Shpk", për procedurën e "E hapur", me REF-68208-11-10-2025, me objekt: "Furnizimi me ujë për fshatrat Picar & Kolonjë të Bashkisë Gjirokastër ", me fond limit 129,188,262.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 11.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a.
3. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues "Liqeni VII" SHPK, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të BOE ankimues "Lis Konstruksion Shpk & "Viante Konstruksion Shpk" dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik "Liqeni VII" SHPK.

7. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Lis Konstruksion Shpk & “Viante Konstruksion Shpk”.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën përcjellëse me nr. 3038/13 prot., datë 13.3.2026, protokolluar me tonën me nr. 437/18 prot., datë 17.03.2026, autortiteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a., ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 353/2026, datë 05.03.2026.

*-Raport Përmbledhës me nr. 3038/12 prot., 12.03.2026 nënshkruar nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;*

I.3. Me shkresën përcjellëse me nr. 577/2 prot., datë 17.3.2026, protokolluar me tonën me nr. 437/20 prot., datë 18.03.2026, autortiteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a., ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 353/2026, datë 05.03.2026.

*-dokumentacion teknik të operatorit ekonomik “Hastoçi” Shpk;*

## **II**

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton:**

II.1. Me shkresën përcjellëse me nr. 3038/13 prot., datë 13.3.2026, protokolluar me tonën me nr. 437/18 prot., datë 17.03.2026, autortiteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a., ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 353/2026, datë 05.03.2026.

*-Raport Përmbledhës me nr. 3038/12 prot., 12.03.2026 nënshkruar nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;*

II.2. Me shkresën përcjellëse me nr. 577/2 prot., datë 17.3.2026, protokolluar me tonën me nr. 437/20 prot., datë 18.03.2026, autortiteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a., ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 353/2026, datë 05.03.2026.

*-dokumentacion teknik të operatorit ekonomik “Hastoçi” Shpk;*

II.3. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik si edhe informacioni i dërguar me shkresat përcjellëse me nr. 3038/13 prot., datë 13.3.2026, protokolluar me tonën me nr. 437/18 prot., datë 17.03.2026 dhe me nr. 577/2 prot., datë 17.3.2026, protokolluar me tonën me nr. 437/20 prot., datë 18.03.2026, nëpërmjet shërbimit postar. KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik por nuk është

kryer ky rivlerësim në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.353/2026, datë 05.03.2026.  
Konkretisht:

**II.3.1.** për operatorin ekonomik “Liqeni VII” Shpk, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.353/2026, datë 05.03.2026, duke rivlerësuar këtë subjekt ofertues dhe pas rivlerësimit statusi nga “I skualifikuar” është ndryshuar në statusin “I kualifikuar”, ku këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me informacionin e dërguar, duke bashkëlidhur edhe Raport Përmbledhës me nr. 3038/12 prot., 12.03.2026 nënshkruar nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

**II.3.2.** për BOE ankimues “Lis Konstruksion Shpk & “Viante Konstruksion Shpk”, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.353/2026, datë 05.03.2026, duke rivlerësuar arsyet e skualifikimit për këtë subjekt ofertues dhe pas rivlerësimit statusi nga “I skualifikuar” nuk ka ndryshuar në zbatim të vendimit të KPP-së, ku këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me informacionin e dërguar, duke bashkëlidhur edhe Raport Përmbledhës me nr. 3038/12 prot., 12.03.2026 nënshkruar nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

**II.3.3.** me shkresat përcjellëse me nr. 3038/13 prot., datë 13.3.2026, protokolluar me tonën me nr. 437/18 prot., datë 17.03.2026 dhe me nr. 577/2 prot., datë 17.3.2026, protokolluar me tonën me nr. 437/20 prot., datë 18.03.2026, nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastrë Sh.a. njofton se (citojmë): .....*[Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik “Liqeni VII” Shpk me shkresën e datës 13.03.2026 ju argumentojmë si më poshtë: .....gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ofertave dhe në zbatim të pikës III.1.8 si dhe pikave III.4, III.4.1, III.4.6, III.4.7 dhe III.4.8 të vendimit përkatës të Komisionit të Prokurimit Publik, të cilët garantojnë të drjetën e operatorëve ekonomikë për trajtim të barabartë dhe për shqyrtim të drejtë të ofertave të tyre, Komisioni I Vlerësimit të Ofertave ka rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurë. Nga ky rishqyrtim rezultoi se, një nga arsyet e përdorura për skualifikimin e disa operatorëve ekonomikë nuk qëndronte në mënyrë të qëndrueshme nga pikëpampja ligjore dhe procedurale. Për rrjedhojë, duke qënë se, e njëjta arsye ishte përdorur edhe për operatorë të tjerë ekonomikë, Komisioni vlerësoi se, në funksion të respektimit të parimit të barazisë së trajtimit dhe për të garantuar një proces të drejtë dhe transparent, kjo arsye skualifikimi nuk duhet të merret më në konsideratë për asnjë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë. Ky rivlerësim u bë edhe në kaudër të ankesave të paraqitura pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga operatorët ekonomikë “Liqeni VII” Shpk dhe BOE “Lis Konstruksion Shpk & “Viante Konstruksion Shpk”, të cilët kanë kundërshtuar skualifikimin e tyre të padrejtë. Në përfundim, autoriteti kontraktor, për të garantuar një proces të drjetë, transparent dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, ka proceduruar me rivlerësimin e ofertave në sistem, duke korrigjuar arsyet e skualifikimit që u vlerësua se nuk qëndronte dhe duke siguruar trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë. Së dyti, në lidhje me arsyet e skualifikimit të publikuara në Buletinine Njoftimeve Publike nr. 13, datë 09.02.2026, sqarojmë se, gjatë fazës fillestare të vlerësimit të ofertave janë evidentuar disa mangësi në dokumentacionin e OE “Hastoçi” Shpk, të cilat janë pasqyruar në vendimin e parë të komisionit. Megjithatë, pas paraqitjes së ankesës së Oe “Liqeni VII” Shpk, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, rishqyrtoi dokumentacionin e*

*parasqitur në SPE dhe konstatoi se, për shkak të një lapsusi gjatë verifikimit fillestar, nuk ishin bërë verifikimet e plota në lidhje me deklarin e një automakinist nga ana e OE ankimes, i cili ishte konsideruar në mënyrë të gabuar si mungesë në stafin teknik.....duke marrë në konsideratë numrin e madh të operatorëve pjesëmarrës dhe volumin e konsiderueshëm të dokumentacionit të dorëzuar, u pa e nevojshme rishqyrtimit të dokumentacionit për secilin operator, me qëllim verifikimin e saktësisë së vlerësimit fillestar dhe shmangien e gabimeve të mundshme që mund të kenë cuar në skualifikim të padrejtë, edhe pse ndaj vendimmarrjes nuk janë paraqitur ankesa nga të gjithë operatorët ekonomikë. Nga ky rishqyrtim i plotë rezultoi se, disa nga mangësitë e evidentuara më parë për OE “Hastoçi” Shpk nuk qëndronin në mënyrë të bazuar.....]*

Me vendimin nr. 353/2026, datë 05.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik, ka vendosur rivlerësimin e procedurës së mësipërme të prokurimit dhe konkretisht rivlerësimin vetëm të ofertës së operatorit ekonomik “Liqeni VII” Shpk, duke e kualifikuar këtë ofertues, si dhe për BOE ankimes “Lis Konstruksion Shpk & “Viante Konstruksion Shpk”, ku statusi I tij vazhdon të jetë I skualifikuar. Por nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik nga verifikimet në Sistemin Elektronik të Prokurimit konstaton se, pikat 1 dhe 2 të dispozitivit të vendimit K.P.P nr. 353/2026, është zbatuar në tejkalim të parashikimeve të këtyre pikave, pasi janë kualifikuar edhe ofertat e operatorëve ekonomikë “Hastoçi” SHPK dhe “Zdrava” SHPK, të cilët në vlerësimin e datës 02.02.2026 kanë qënë të skualifikuar, sikurse është përmendur edhe në pikën II.3, të vendimit të sipërpërmendur të Komisionit të Prokurimit Publik.

Sa më sipër Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të rivlerësojë procedurën e mësipërme të prokurimit, duke skualifikuar ofertat e operatorëve ekonomikë “Hastoçi” SHPK dhe “Zdrava” SHPK, sipas statusit që kanë patur në datën 02.02.2026, si dhe duke lënë të kualifikuar ofertën e operatorit ekonomik “Liqeni VII” Shpk, sipas pikës 1 të dispozitivit të vendimit të K.P.P nr. 353/2026, datë 05.03.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me REF-68208-11-10-2025, me objekt: “Furnizimi me ujë për fshatrat Picar & Kolonjë të Bashkisë Gjirokastër”, me fond limit 129,188,262.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 11.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e mësipërme të prokurimit, duke skualifikuar ofertat e operatorëve ekonomikë “Hastoçi” SHPK dhe “Zdrava” SHPK, sipas statusit që kanë patur në datën 02.02.2026, si dhe duke lënë të kualifikuar ofertën e

operatorit ekonomik “Liçeni VII” Shpk, sipas pikës 1 të dispozitivit të vendimit nr. 353/2026, datë 05.03.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

